REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
N/Nr. 56/23
Data/Datum 09.02.23
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljubljanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel:+ 383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

PSH. nr. 56/23

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2, nenin 108/A paragrafi 3.1 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-092, nenin 60 par 1 nën paragrafi a) i Rregullores për Prokurimin Publik 001/2022, si dhe nenin 17 paragrafi 3 të Rregullores së Punës së OSHP-së nr. 01/2020, me numër të protokollit 83/2020 e amandamentuar me datën 30.09.2022, pas shqyrtimit të ankesës së OE GUARD DE CAPITAL SH.P.K., kundër / lidhur me aktivitetin e prokurimit "Shërbime të Dezinfektimit, Dezinsektimit dhe Deratizimit në objektet Policore." me numër të prokurimit 214-22-5200-2-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – POLICIA E KOSOVËS, Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit, Vjosa Gradinaj Mexhuani, me datën: 08/02/2023, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet si e palejuar, ankesa e GUARD DE CAPITAL SH.P.K. me nr. të protokollit 2023/0056, e datës 31/01/2023, ankesë kjo e parashtruar për aktivitetin e prokurimit "Shërbime të Dezinfektimit, Dezinsektimit dhe Deratizimit në objektet Policore", me numër të prokurimit 214-22-5200-2-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – POLICIA E KOSOVËS.

I lejohet, autoritetit kontraktues – POLICIA E KOSOVËS, që të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit "Shërbime të Dezinfektimit, Dezinsektimit dhe Deratizimit në objektet Policore", me numër të prokurimit 214-22-5200-2-1-1, përkitazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit.

A r s y e t i m

Policia e Kosovës në cilësinë e autoritetit kontraktues me datën 19 janar 2023, ka publikuar Formularin standard për Korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara (Njoftimin për Kontratë) në ora 15:32. Hapja e ofertave është planifikuar të bëhet me datën 31 janar 2023.

Operatori ekonomik GUARD DE CAPITAL SH.P.K me datën 30 janar 2022 në ora 11: 54, ka parashtruar në AK, Kërkesën për Rishqyrtim.

AK me datën 30 janar 2023, ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim të AK-së në ora 16:14.

Operatori ekonomik me të dhëna të cekura si më lartë, me datën 31 janar 2023, si palë e pakënaqur me vendimin për refuzim të AK-së, ka parashtruar ankesë në OSHP, me nr. 56/23 (numër protokolli).

Pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjithë dokumentacionit të lëndës, që gjendet në sistemin e e-prokurimit, vërehet se ankesa e OE ankues është e palejuar sepse e njëjta është parashtruar jashtë afatit për shqyrtim në AK.

Ankesa e dorëzuar në AK është në kundërshtim me nenin 108/A të LPP-së, si dhe nenin 60 të Rregullores nr. 001/2022 për prokurim publik ku thuhet:

60.1 Kërkesa për rishqyrtim duhet të përmbajë të dhënat në pajtim me formularin F02 dhe duhet të dorëzohet tek autoriteti përkatës kontraktues nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik, funksioni "kërkesat për rishqyrtim" brenda afateve të mëposhtme:

a) Kurdo që kërkesa për rishqyrtim ka të bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit se paku pesë (5) ditë para afatit të fundit për dorëzim të ofertave. Në kalkulim të afateve kohore dita e dorëzimit të ofertave është dita (0). Ky afat nuk aplikohet në rastet kur AK bën zgjatje të afatit të fundit për dorëzim të ofertave pas vendimit për refuzim të kërkesës për rishqyrtim sipas Nenit 63.1.1 të Rregullores Nr.001/2022 për prokurimin publik.

Andaj duke u bazuar në sqarimin e dhënë si më lartë, OSHP konsideron se ankesa e OE ankues është e palejuar sepse e njëjta është parashtruar jashtëafatit ne AK.

Poashtu, OE ankues nuk ka paguar tarifën e paraparë me rastin e parashtrimit të ankesës.

Kryetarja e OSHP-së ne pajtim me nenin 105, 106 dhe 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetarja e OSHP-se

Vjosa Gradinaj Mexhuani

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale, dhoma e shkallës se parë në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK-së PK

1x1 OE ankues

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.